



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:133112

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625449

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurve V.M. dhe Sh.M., që të dy nga fshati ..., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.954/21 të datës 07.07.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 04.04.2024, në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Ardian Emini prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, të pandehurit V.M. dhe Sh.M., pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve V.M. dhe Sh.M., më datë 04.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 26.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit

I.V.M., nga i ati H., e ëma R. e gjinisë R., i lindur më datë ..., në Zvicër, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj, me numër personal ..., i pa martuar, me profesion saldues, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II.SH.M., nga i ati H., e ëma R. e gjinisë R., i lindur më datë ..., në Prishtinë, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj, me numër personal ..., i pa martuar, me profesion saldues i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

Sepse:

Më datë 05.05.2021, rreth orës 17:30 min, në fsh....-Ferizaj, në bashkëkryerje me dashje me qëllim të shkaktimit të lëndimit trupor të dëmtuarit F.V., deri sa ka qenë duke shëtitur me veturë së bashku me katër shoqe dhe shokun e tij E., i cili ndërkohë pranon një thirrje telefonike nga i pandehuri Sh., dhe me të kuptuar vendin se ku gjenden arrin me veturën e tij "Golf" së bashku me të pandehurin (vëllaun) V. dhe i njëjti pa paralajmërim e godet të dëmtuarin me grushte në kokë po ashtu edhe i pandehuri Sh. e godet me shqelma dhe grushte në pjesë të ndryshme të trupit si pasojë e se cilës i dëmtuari pëson lëndime trupore dhe atë ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të kokës dhe të bërrylit të dorës të cilat lëndime janë te natyrës se lehte trupor me pasoja të përkohshme në shëndet

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale **Lëndim i lehtë trupor** nga 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurit i:

G J Y K O N

I. Të pandehurin V.M. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

II. Të pandehurin Sh.M. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

III. I dëmtuari F.V. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

IV. Obligohen të pandehurit V.M. dhe Sh.M. që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 07.07.2021, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.954/21, kundër të pandehurve V.M. dhe Sh.M. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me datë 04.04.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Ardian Emini, të pandehurit V.M. dhe Sh.M..

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila iu vihet në barrë andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 2 dhe 322 paragrafi 1 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësinë nga ana e të pandehurve, për të vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: në pajtim me nenin 351 të KPP-së, paraqes fjalën përfundimtare, mbetem në tërësi pranë aktakuzës kundër të pandehurve V. dhe Sh.M. për veprën penale të kryer në bashkëkryerje nga neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe se nga provat personale dhe materiale siç janë ekspertiza mjeko ligjore me numër të referencës 0../2021 e datës 30.06.2021, deklarata e të dëmtuarit F.V. e dhënë në polici me datë 05.05.2021 dhe me datë 12.05.2021; raporti mjekësore nga Qendra Emergjente në Ferizaj me numër rendor: .. i datës 05.05.2021, deklarata e dëshmitarit E.N. e dhënë në polici me datë 12.05.2021, deklarata e të pandehurit V.M. e dhënë në polici me datë 14.05.2021, deklarata e të pandehurit Sh.M. e dhënë në polici me datë 15.05.2021, deklarata e dëshmitares M.R. e dhënë në polici me datë 12.05.2021, pa mëdyshje u vërtetua se të akuzuarit në bashkëkryerje dhe me dashje dhe me qëllim të cenimit të integritet trupor të dëmtuarit duke përdorura forcën i kanë shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit ashtu si janë të përshkuara në ekspertizën mjeko – ligjore. Andaj duke pasur parasysh të gjitha më lartë i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të ju shqiptoj një dënim të paraparë sipas kodit penale për

veprën penale për të cilën akuzohen me rastin e shqiptimit dhe matjes së dënimit si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë e po ashtu që të akuzuarit për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë renduese të merret parasysh se kjo veprë penale është duke u shfaqur si dukuri në shoqëri.

I pandehuri V.M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: jam penduar për veprën penale që e kam kryer, kërkoj falje publike dhe me të dëmtuarin i kemi rregulluar raportet, është hera e parë që kryej veprë penale, jetoj me familjen time me prindërit dhe dy vëllezërit, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as vepra të tjera penale, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri Sh.M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: jam penduar për veprën penale që e kam kryer, kërkoj falje publike dhe me të dëmtuarin i kemi rregulluar raportet, është hera e parë që kryej veprë penale, jetoj me familjen time me prindërit dhe dy vëllezërit, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as vepra të tjera penale, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë dhe kërkoj nga gjykata që ta ketë parasysh edhe moshën tonë të re kur ka ndodhur ngjarja.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore të cilat kërkohen me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve nuk është kundërshtuar nga ana e palëve të cilat ishin prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurve dhe të njëjtit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë. Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-CF-852 e lëshuar nga Stacioni Policor në Ferizaj me datë 05.05.2021, Raporti i oficerit me numër: 2021-CF-852 e datës 05.05.2021, Raporti mjekësor me numër rendor të protokollit ... i datës 05.05.2021 i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm – Qendra Emergjente në Ferizaj, Ekspertiza mjeko ligjore e datës 30.06.2021 me numër të referencës: 0./2021 e lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë nga Dr.V.R.K., Deklarata e të pandehurit V.M. e dhënë në Stacionin Policor në

Ferizaj me datë 14.05.2021, Deklarata e të pandehurit Sh.M. e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 15.05.2021, Deklarata e të dëmtuarit F.V. e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 05.05.2021 dhe me datë 12.05.2021, Deklarata e dëshmitarit E.N. dhënë në polici me datë 12.05.2021, Deklarata e dëshmitares M.R. e dhënë në polici me datë 12.05.2021, si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit V.M. dhe Sh.M., në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4. lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit V.M. t'i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej një (1) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht si dhe të pandehurit Sh.M. dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryerësve dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin V.M. ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim gjyqësor, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale që e ka kryer dhe ka kërkuar falje publike, është hera e parë që kryen vepër penale, moshën e re në kohën e kryerjes së veprës penale, gjendjen e dobët ekonomike të tij, është mbajtës i familjes si dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të

kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit si dhe moshën e re të palës së dëmtuar.

Ndërsa për të pandehurin Sh.M. si rrethana lehtësuese ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim gjyqësor, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale që e ka kryer dhe ka kërkuar falje publike, është hera e parë që kryen vepër penale, moshën e re në kohën e kryerjes së veprës penale, gjendjen e dobët ekonomike, moshën e tij të re, është mbajtës i familjes dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit si dhe moshën e re të palës së dëmtuar.

Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht e që në nenin 47 të KPRK-së përcaktohet se qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurve mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij program”*. Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi që palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko – civil.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurit që secili veç e veç të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2021:148167, me datë 26.04.2024

Zyrtarja ligjore,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.